

Znj. \_\_\_\_\_

E nderuar,

Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 6703 Prot datë 29.04.2021, për informacion mbi Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve në Bashkinë Shkodër, ju informojmë si vijon:

Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve është një strukturë brenda Drejtorisë së Shërbimeve Sociale të Bashkisë Shkodër dhe ka në përbërje 9 punonjës social të cilët janë pjesë e rrjetit të qendrave komunitare “Për Familjen” që mbulojnë 5 lagjet e qytetit. Këto qendra komunitare janë të shtrira edhe në njësitë administrative si në; Guri i Zi, Dajç, Postribë, Rrethina, Velipojë etj.

Pranë Qendrave Komunitare “Për Familjen” Bashkia Shkodër ofrohen shërbime për mbrojtjen e fëmijëve, shërbime komunitare bazë si informim, këshillim, orjentim, shërbime për familjen dhe fuqizim ekonomik, shërbime arsimore, shërbime lëvizëse, etj.

Aktualisht Drejtoria e Shërbimeve Sociale është në proces riorganizimi për të ngritur dhe bërë funksionale Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJVNR), të cilat në kontekstin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqërorë është planifikuar të përbëhen nga punonjës për mbrojtjen e fëmijëve, punonjës social të zonës dhe administrator shoqërorë.

Numri i punonjësve sociale të punësuar në Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve është i domosdoshëm të rritet dhe të shtrihen me tepër në njësitë administrative veçanërisht në ato malore. Por duhet të theksohet se burimet financiare janë të limituara dhe aktualisht shërbimet në qendrat komunitare “Për Familjen” dhe punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve financohen vetëm me burimet financiare të Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me donatorë të ndryshëm. Në këtë kuadër vlerësojmë shumë të rëndësishme të nënvizojmë edhe mos respektimin nga ana e qeverisë, të nenit 47 “Fondi Social” dhe nenit 48 “Fondet e Financimit” të ligjit 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, e cila që nga aprovimi i këtij ligji nuk ka lëvruar asnjë fond për shërbimet sociale të Bashkisë Shkodër, duke sjellë vështirësi në ngritjen dhe administrimin e shërbimeve shoqërore në mbështetje të individëve dhe familjeve në vështirësi social- ekonomike.

Sa i takon fondit të shpenzuar nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve lidhur me rastet e fëmijëve të abuzuar apo ngacmuar seksualisht, për periudhën 2019-2020 kemi trajtuar vetëm një rast (dyshuar viktimë e abuzimit apo ngacmimit seksual) rast të cilin e kemi menaxhuar në bashkëpunim me organizatat partnere ku është siguruar këshillim dhe trajtim psikologjik me vlerën 20,000 lekë për një periudhë 1 mujore. Rasti vazhdon të ndiqet nga punonjës social të

qendrës Komunitare “Për Familjen” pranë Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me aktorët e tjerë përgjegjës për të siguruar mbrojtjen e fëmijës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORIA E SHERBIMEVE SOCIALE, SHENDETIT PUBLIK DHE STREHIMIT

BASHKIA SHKODER